



RTK 1

Mentor Shala  
Drejtor  
Prishtinë

Rasti Nr. 2018/190

Ref:1812/1377/KPM/mf

**VENDIM**

**Lidhur me Ankesën Nr. 2018/190 e z. Milaim Sejdini (Palë Ankuese) kundër RTK 1 (Palë Përgjegjëse)**

**Faktet**

1. Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) ka miratuar Kodin e Etikës për Ofriuesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovë KKPM-2016/3, i cili ka hyrë në fuqi më 11 tetor 2016. Me Kodin e Etikës KKPM-2016/03 janë përcaktuar rregullat e sjelljes dhe të punës së shërbimeve mediale audiovizuale në pajtim me dispozitat ligjore që janë të domosdoshme në një shoqëri demokratike.
2. KPM me datën 31 tetor 2018 ka pranuar një ankesë nga z. Milam Sejdini ndaj kronikës "Përmirësimet në Arsim", të transmetuar me datën 18 tetor 2018 në edicionin e lajmeve të orës 19:30 në RTK 1, përmes së cilës Pala Ankuese pretendon se Pala Përgjegjëse përmes kësaj kronike: "*ka pasur mungesë të interesimit të publikuesit të lajmit të transmetuar në vërtetësi të lajmit, qasje të njëanshme, lajm të pa balancuar, nuk është bërë dallimi në mes të opinionit dhe lajmit si dhe shprehjet e përdorura gjatë trasnmetimit të lajmit janë më qëllim të denigrimit të personalitetin të tij*".
3. KPM me datën 5 nëntor 2018 përmes një shkresë e ka njoftuar Palen Përgjegjëse për ankesën e pranuar nga Pala Ankuese dhe ka kërkuar sqarim brenda tre (3) ditësh lidhur me pretendimet e ankesës.
4. KPM me datën 6 nëntor 2018 ka pranuar përgjigje nga Pala Përgjegjëse duke pretenduar se kanë vepruar sipas standardeve profesionale të gazetarisë si dhe konform rregullativës ligjore gjatë transmetimit të kësaj kronike.
5. KPM ka analizuar ankesën e Palës Ankuese si dhe ka monitoruar kronikën e lartpërmendor dhe në bazë të Raportit të monitorimit të datës 8 nëntor 2018 ka gjetur se Pala Përgjegjëse ka vepruar në kundërshtim me Kodin e Etikës KKPM-2016/03.

6. KPM, pas të gjeturave nga Raporti i monitorimit, me datën 27 nëntor 2018 i ka dërguar Palës Përgjegjëse Njoftim për Shkelje me të cilin e ka njoftuar për shkeljet e bëra dhe i ka kërkuar të veprojë në pajtim me Kodit të Etikës KKPM-2016/03.

### **Analiza Ligjore**

7. Komisioni bazuar në të gjitha faktet dhe analizat e lartpërmendura konstaton Pala Përgjegjëse është gjetur në shkelje të nenit 6, paragrafi 1 dhe 7, të Kodit të Etikës KKPM-2016/03.
8. Bazuar në monitorimin që i është bërë kronikës së transmetuar me titull "*Përmirësimet në Arsim*", vërehet se Pala Përgjegjëse ka vepruar në kundërshtim me nenin 6, paragrafi 1, të Kodit të Etikës KKPM-2016/03, i cili përcakton se:

*"OSHM-të duhet të raportojnë lajme me saktësi dhe t'i paraqesin ato në mënyrë të paanshme. Ata nuk duhet të transmetojnë material për të cilin e dinë ose duhet të dinë se është i pavërtetë ose mashtrues".*

KPM ka gjetur se Pala Përgjegjëse edhe përkundër faktit se palët e përfshira në kronikë pretendojnë se ndaj Palës Ankuese është duke u zhvilluar proces hetimor nga organet kompetente për ngacmim seksual, nuk ka ndërmarrë asnjë veprim ose prononcim të organeve të rendit në lidhje me këtë çështje në mënyrë që të vërtetojë saktësinë e informacionit, ashtu siç kërkohet me nenin 6, paragrafi 1, të Kodit të Etikës KKPM-2016/03.

9. Bazuar në Raportin e monitorimit, KPM gjithashtu ka gjetur se Pala Përgjegjëse ka vepruar edhe në kundërshtim me nenin 6, paragrafi 7, të Kodit të Etikës KKPM-2016/03, i cili përcakton se:

*"OSHM-të duhet të ofrojnë prezantim të perspektivave të ndryshme në mënyre korrekte dhe të drejtë. Në qoftë se njëra palë refuzon që të ofrojë pikëpamjen e saj, publiku duhet të informohet për këtë refuzim".*

KPM bazuar në Raportin e monitorimit, gjithashtu ka gjetur se Pala Përgjegjëse ka dështuar të sigurojë trajtim të drejtë dhe të paanshëm gjatë transmetimit të kronikës rrëth Palës Ankuese, pasi që përveç deklarimit të Dekanës së Fakultetit të Mjeksisë znj. Manxhuka-Kërliu, nuk janë dhënë pikëpamje tjera lidhur me kronikën, përfshirë këtu palët tjera të përmendura në kronikë, si Palës Ankuese dhe organet e rendit, ashtu siç përcaktohet me nenin 6, paragrafi 7, të Kodit të Etikës KKPM-2016/03.

10. KPM në bazë të monitorimit të kronikës ka gjetur se Pala Përgjegjëse edhe përkundër faktit se nuk ka ndërmarrë asnjë veprim për t'u kujdesur për vërtetësinë e lajmit, gjatë transmetimit të kronikës ka zbuluar identitetin e Palës Ankuese duke i cënuar kështu dinjitetin dhe integritetin.

Prandaj, KPM duke u bazuar në faktet e lartpërmendura ka gjetur Pala Përgjegjëse ka bërë shkelje të nenit 6, paragrafi 1 dhe 7, të Kodit të Etikës KKPM-2016/03.

### **Vendim**

11. Komisioni i KPM-së bazuar në të gjitha faktet dhe analizat e lartpërmendura urdhëron Palën Përgjegjës që në afat prej shtatë (7) ditësh t'i ofrojë Palës Ankuese të drejtën për t'u deklaruar në lidhje me kroniken "Përmirësimet në Arsim" në mënyrë që Palës t'i sigurohet një prezantim objektiv dhe korrekt, ashtu siç përcaktohet me nenin 6, paragrafi 7, të Kodit të Etikës KKPM-2016/03.
12. Të sanksionohet Pala Përgjegjëse me gjobë në vlerën prej dymijë (2,000) euro, në pajtim me nenin 30, paragrafi 1.3 të Ligjit të KPM-së, për shkelje të nenit 6, paragrafi 1 dhe 7, të Kodit të Etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës KKPM-2016/03.

### **E drejta për Ankesë**

13. Ankesat i parashtronen Bordit për Ankesa brenda tridhjetë (30) ditësh nga pranimi i vendimit të KPM-së në pajtim me nenin 29, paragrafi 5, të Ligjit të KPM-së. Ankesa bëhet me shkrim dhe duhet të përcillet me dokumente ose dëshmi që mund të kërkohen nga Bordi i Ankesave në pajtim me nenin 42, paragrafi 2, të Ligjit të KPM-së.
14. Bordi për Ankesa do t'i merr parasysh vetëm ankesat e bazuara në informacione ligjërisht relevante të cilat nuk ishin të disponueshme në kohën e marrjes së vendimit të KPM-së, apo të bazuara në mundësi se ekzistonte gabim procedural dhe material i bërë nga ana e KPM-së gjatë marrjes së vendimit.

  
\_\_\_\_\_  
Muja FERATI  
Kryetar



05.02.2019  
Datë